



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 324 Prot.

Tiranë, më 12.01. 2015

Lënda: Njoftim

Agjencia e Prokurimit Publik ju rikujton Autoriteteve Kontraktore që, në zbatim të dispozitave ligjore të prokurimit publik, çdo procedurë prokurimi e krijuar në sistemin e prokurimit elektronik duhet të përfundohet nëpërmjet një vendimi, që mund të jetë **Arkivimi** i kësaj procedure ose **Anullimi** i saj.

Bashkalidhur këtij njoftimi është lista e Autoriteteve Kontraktore me procedurat përkatëse të papërfunduara për vitin 2014.

Agjencia e Prokurimit Publik i kërkon Autoriteteve Kontraktore respektive që, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të marrin masat e nevojshme për të përfunduar procedurat e mësipërme në sistem brenda datës 23.01.2015.

Tërheqim vëmendjen e Autoriteteve Kontraktore se, mos kryerja e veprimeve si më sipër, do të përbëjë shkak për fillimin e hetimit administrativ dhe penalizimin e personave përgjegjës në përputhje të përcaktimeve të nenit 72 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti